



Nr. 1285/3 Prot.

Tiranë, më 15.4.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 50, Dt. 15.04.2022 PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË “NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SH.A, TIRANË ✓

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” sh.a Tiranë;

VENDOSA:

1. Prishjen e shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” sh.a Tiranë dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Znj. Ulpiana Hysaj, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
4. Znj. Eljona Hoxha. Auditues Ligjor të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ

